



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË
PROCESVERBAL

Nr. 273/Prot.

Tiranë, më 10.12.2020

Sot, më datë 10.12.2020, ditën e enjte, ora 13.00, Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi një mbledhje plenare jashtë radhës, thirrur nga Kryetari, bazuar në nenet 164 deri 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Këshilli u mblodh në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Z. Gent Ibrahim
2. Z. Alfred Balla
3. Znj. Esmeralda Keshi
4. Z. Kosta Beluri
5. Z. Bujar Sheshi
6. Z. Sandër Beci
7. Znj. Nurihan Seiti
8. Z. Vatë Staka

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Gent Ibrahim, i cili, në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pasi verifikoi pjesëmarrjen e anëtarëve, bëri hapjen e saj në kushtet e kuorumit dhe kaloi në paraqitjen e rendit të ditës.

Rendi i ditës:



1 Miratimi i projekt-vendimit “Për caktimin e përkohshëm të prokurorit Henrik Haxhiraj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

Z. Ibrahim sqaron se kjo mbledhje zhvillohet në kushte urgjente për shkak të gjendjes shëndetësore të drejtuesit të përkohshëm të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, i cili e ka të pamundur të ndjekë normalisht proceset gjyqësore. Në mënyrë që të sigurohet në vazhdimësi funksionaliteti i kësaj prokurorie, është e nevojshme që të bëhet një shtyrje, caktim i përkohshëm, në këtë pozicion. Z.Beci ftohet të relatojë.

Z. Beci relatton se, për shkak të gjendjes shëndetësore (infektim me virusin COVID 19) të z. Gjon Fusha, i caktuar përkohësisht në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosi me Vendimin nr.258, datë 11.11.2020, caktimin e përkohshëm të z. Henrik Haxhiraj, në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit, Gjirokastrë. Kjo, në kushtet kur gjendja shëndetësore e z. Gjon Fusha vazhdon të paraqitet e njëjtë dhe ai nuk mund të ndjekë proceset gjyqësore, gjë e cila sjell vështirësi në funksionimin e prokurorisë, pasi ai aktualisht është prokurori i vetëm në atë prokurori apeli.

Në këtë situatë, del e nevojshme shtyrja e caktimit të përkohshëm e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. Komisioni Zhvillimit të Karrierës ka evidentuar si kandidat z. Henrik Haxhiraj, aktualisht drejtues i kësaj prokurorie.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, bazuar në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, propozon që prokurori Henrik Haxhiraj të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë edhe për një afat tjetër njëmuajor, nga data 11.12.2020 - 10.01.2021, pasi ai plotëson kushtet e përcaktuara në ligj dhe në Rregulloren e lartpërmendur.

Duke qenë se nuk ka pyetje dhe komente të mëtejshme, **Z. Ibrahim** vijon me leximin e projektvendimit dhe e hedh atë në votim.



Të gjithë janë dakord. Miratohet me 8 vota pro.

(Vendimi i plotë gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit).

Z. Ibrahim falënderon anëtarët për diskutimet e tyre dhe në përfundim, duke mos patur pika të tjera për diskutim, e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit

Sonila Çeliku



KRYETARI

Gent Ibrahim



Shënim 1:

Në këtë procesverbal janë/nuk janë vënë në dukje pasaktësitë e mundshme, të konstatuara nga anëtarët e KLP-së.

Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të kryetarit Nr. ___ Datë ___ 2020/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr. ___ datë ___ (bashkëlidhur kopjet e dokumenteve).

Procesverbali i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së, datë 23/12/2020

Procesverbali të arkivohet.

PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

Frederik Sulisufi

